

LIGJ
Nr.7649, datë 16.12.1992

PËR KRIJIMIN E BANKËS SË PËRBASHKËT ITALO-SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet krijimi i Bankës së përbashkët Italo-Shqiptare sipas statutit që i bashkëngjitet këtij ligji dhe që është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Banka Italo-Shqiptare do të jetë subjekt i normave të ligjit nr.7560, datë 28.4.1992 "Për sistemin bankar në Shqipëri", dhe të ligjit nr.7559, datë 22 prill 1992 "Për Bankën e Shqipërisë".

Neni 3

Ortakëve të huaj të Bankës Italo-Shqiptare u është garantuar transferimi i lirë në valutë të konvertueshme i fitimeve dhe, në rastet e uljes së kapitalit, të tërheqjes së ortakëve ose të mbylljes së bankës, garantohet transferimi i kuotës që u përket në të njëjtën valutë në të cilën u ofrua.

Neni 4

Shtetasit e huaj që do të kryejnë funksionin e administratorëve, të drejtuesve, nëpunësve ose konsulentëve të Bankës Italo-Shqiptare, përjashtohen nga çdo taksë mbi të ardhurat që vijnë nga funksione të tilla, përderisa i nënshtrohen taksimit në vendin e tyre, duke rezervuar të drejtën e zbatimit të marrëveshjes të tatimit të dyfishtë ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj italiane me hyrjen e saj në fuqi.

Të ardhurat e tyre në valutë të konvertueshme, mund të transferohen lirisht.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekreten nr.406, datë 31.12.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

BANKA ITALO-SHQIPTARE

STATUTI

KRJIMI, SELIA DHE PERIUDHA E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË, OBJEKTI-KAPITALI

Neni 1

Banka Italo-Shqiptare është një shoqëri aksionare, e krijuar dhe që funksionon në përputhje me ligjin nr.7560, datë 28 prill 1992 "Për sistemin bankar në Shqipëri" dhe ligjin nr.7649, datë

16.12.1992 "Për krijimin e Bankës së Përbashkët Italo-Shqiptre". Banca di Roma dhe Banka Kombëtare e Shqipërisë janë themeluesit e saj.

Neni 2

Shoqëria e ka selinë në Tiranë dhe, në bazë të ligjeve në fuqi, do të mund të hapë filiale e zyra përfaqësimi të ndryshme brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Banka Italo-Shqiptare do të zhvillojë veprimtarinë e saj deri më datën 31 dhjetor 2050, përveç mundësisë së zgjatjes së këtij afati nga Asambleja.

Neni 4

Banka Italo-Shqiptre ka si objekt grumbullimin e kursimeve dhe dhënien e kredive në forma të ndryshme.

Ajo mund të marrë pjesë dhe do të kryejë, sipas ligjeve në fuqi, të gjitha operacionet dhe shërbimet bankare e financiare të lejuara, si dhe çdo instrument tjetër që lidhet me veprimtarinë e vetë Bankës. Në mënyrë të veçantë, mbi bazën e kushteve të caktura, ajo do të zhvillojë në favor të Shqipërisë, dhe për llogari të Bankës së Shqipërisë, sipas kërkesës së qeverisë shqiptre, funksionet e organizimit e të administrit të ndihmave dhe financimeve ndërkombëtare e, në mënyrë të veçantë, do të ndihmojë me mjete financiare procesin e privatizimit të ekonomisë. Në kryerjen e funksioneve të tilla Banka Italo-Shqiptre do të mbështetet në përvojën dhe strukturën ndërkombëtare të Banca di Roma dhe të shoqërive të tjera të varura nga ajo.

Neni 5

Kapitali i Bankës Italo-Shqiptre përbëhet:

- a) nga kapitali themelor;
- b) nga fondi i rezervës së detyrueshme;
- c) nga fonde të tjera rezervë.

Kapitali shoqëror është 10 milionë dollarë amerikanë, i ndarë me nga 5 milionë dollarë për secilin palë dhe në 100 aksione me 100 000 dollarë secili. Shuma prej jo më pak se 500 000 dollarësh do të derdhet menjëherë, kurse pjesa tjetër do të derdhet në të holla ose me konfirmimin e kredive a të të mirave materiale, brenda një viti nga krijimi i saj.

Shuma e kredive dhe vlera e të mirave materiale të vërtetuara verifikohen nga këshilli administrativ, me miratimin e Kolegjit të kontrollorëve.

Neni 6

Çdo aksion ka të drejtën e një vote. Aksionet janë emërore dhe të pandashme. Në rastin e ndonjë detyrimi apo të çdo lloj kushti tjetër për aksionet, e drejta e votës i takon gjithmonë ortakut të ngarkuar.

Transferimet e aksioneve të Bankës janë të vlefshme vetëm pasi të jetë bërë një kërkesë e dokumentuar qysh më parë, nën kujdesin e të ngarkuarit të ri, dhe të ndiqet kjo nga një shënim i veçantë në librin e ortakëve.

Në rastet e shtimit të kapitalit, e drejta e zgjedhjes mbi aksionet e reja u rezervohet aksionarëve në përpjesëtim me aksionet që zotëron secili. Një e drejtë e tillë vlen brenda gjatësëdhjetë ditëve nga miratimi i bërë nga Asambleja për shtimin e kapitalit të shoqërisë.

Me miratimin e shtimit të kapitalit, Asambleja përcakton mënyrat e vendosjes së aksioneve që do të mbeten të paprekura. Banka Italo-Shqiptare me miratimin e Bankës së Shqipërisë, mund të emetojë obligacione edhe të konvertueshme, si edhe letra të tjera me vlerë. Kushtet e emisionit janë të përcaktuara nga Asambleja e aksionarëve ose me autorizimin e saj nga Këshilli administrativ.

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

Neni 7

Asambleja e aksionarëve, e krijuar sipas rregullave, paraqet bashkimin e ortakëve. Ajo mund të mbledhet pranë selisë së bankës ose në një vend tjetër, në Shqipëri ose në Itali, gjë që përcaktohet në njoftimin e mbledhjes.

Neni 8

Asambleja e zakonshme, ka të drejtë të marrë këto vendime:

- a) Zgjedhjen e administratorëve, përvaktimin paraprak të numrit të tyre, dhe për përcaktimin e pagave të tyre;
- b) Zgjedhjen e presidentit dhe numrit të Kolegjit të kontrollorëve, si dhe përcaktimin e pagave të tyre;
- c) Miratimin e bilancit vjetor dhe destinacionin e të ardhurave të bilancit;
- ç) Pranimin e çdo lloj argumenti tjetër të vendosur në rendin e ditës.

Asambleja miraton bilancin brenda tramujorit të parë të çdo viti, Asamblesë së jashtëzakonshme i janë rezervuar vendimet që vijnë:

- a) Shkrirja me banka të tjera.
- b) Mbyllja e bankës, emërimi i likuiduesit, likuidiesve dhe pagave të tyre.

Asambleja mbledhet me njoftimin e presidentit ose të personit që e zëvendëson; në njoftimin e mbledhjes duhet të tregohet rendi i ditës, vendi, data dhe ora e mbledhjes.

Në të njëjtin njoftim do të tregohet dita dhe ora e mbledhjes së dytë, që do të mbahet në rast se mbledhja e parë është ndërprerë, mbasi sipas statutit nuk ka qenë e pranishme pjesa e nevojshme që mbledhja e Asamblesë të quhet e vlefshme.

Të drejtën për të marrë pjesë në Asamblenë e aksionarëve e ka edhe aksionari që rezulton i regjistruar në librin e ortakëve, të paktën pesë ditë para asaj të fiksuar për thirrjen e mbledhjes së parë dhe që brenda të njëjtit afat të ketë depozituar aksionet pranë selisë së bankës, ose instituteve të kreditit që përcaktohen në njoftimin e mbledhjes.

Ortakët që kanë të drejtë të marrin pjesë në Asamble, duhet të bëjnë këtë personalisht ose, në rast nevojë, përmes një përfaqësuesi të autorizuar sipas statutit, ose një përfaqësuesi të caktuar, me autorizimin e shkruar në biletën e pranimi që i dorëzohet bankës. Një autorizim i tillë do të vlejë vetëm për një mbledhje të Asamblesë, në thirrjen e parë dhe të dytë. Administratorët dhe punonjësit e Bankës nuk mund të paraqiten si ortakë në Asamble.

Mbledhjet e Asamblesë janë të vlefshme edhe pa njoftim paraprak, me kusht që të jenë të pranishëm të gjithë ata që përfaqësojnë të gjithë kapitalin e bankës, si dhe kontrolluesit efektivë, presidenti dhe administratori i deleguar.

Neni 9

Asambleja e radhës (e zakonshme) zhvillohet në mënyrë të rregullt kur marrin pjesë shumë anëtarë, të cilët përfaqësojnë vetë ose nëpërmjet personave të autorizuar prej tyre:

- në mbledhjen e parë, pjesën më të madhe të kapitalit të Bankës;
- në mbledhjen e dytë, cilëndo pjesë të kapitalit të Bankës.

Në mbledhjen e parë dhe të dytë Asambleja miraton me shumicë votash të aksioneve të paraqitura në mbledhje.

Asambleja e jashtëzakonshme qoftë në mbledhjen e parë apo në të dytën, vendos gjithmonë me shumicë votash të aksioneve të paraqitura në mbledhje, me kusht që të votojnë pro të dy ortakët thmeleues.

Neni 10

Asambleja drejtohet nga presidenti i Bankës, ose, në mungesë të tij nga personi që e zëvendëson.

Presidenti i Asamblesë emëron një sekretar, duke caktuar, në rast se është e nevojshme, edhe një person që nuk është aksionar. Në asambletë e jashtëzakonshme funksionet e sekretarit kyhen nga një noter.

I takon presidentit të Asamblesë të verifikojë të drejtën e pjesëmarrjes, të sigurojë rregullshmërinë e mbledhjeve dhe të krijimit të Asamblesë, drejtimin dhe radhën e diskutimeve, si dhe të vendosë radhën dhe mënyrën e votimit.

Vendimet e Asamblesë duhet të shënohen në procesverbal, të redaktuar nga personi që kryen funksionet e sekretarit, dhe të nënshkruar nga presidenti i Asamblesë, nga vetë sekretari dhe nga vëzhguesit, në rast se emërohen të tillë.

Vendimet e Asamblesë, të marra në përputhje me ligjin dhe statutin e tanishëm, janë të detyrueshme për të gjithë ortakët, edhe për ata që nuk kanë marrë pjesë ose që nuk janë të një mendimi.

ADMINISTRIMI

Neni 11

Banka administrohet nga një Këshill administrativ i përbërë nga 6 deri 9 anëtarë të emëruar nga Asambleja e ortakëve.

Këshilli zgjedh nga gjiri i vet presidentin dhe një zëvendëspresident. Ai emëron një sekretar, i cili mund të zgjidhet edhe jashtë këshillit.

Këshilli administrativ emërohet për një periudhë prej tre vjetësh. Pezullimi i administratorëve për shkak të skadimit të mandatit ka efekt nga çasti kur Këshilli administrativ krijohet përsëri.

Në rast se njëri prej administratorëve pezullohet, këshilli merr masa paraprake për ta zëvendësuar me vendim të miratuar nga Kolegji i kontrollorëve. Administratorët e emëruar në këtë mënyrë qëndrojnë në detyrë deri në asamblenë e ardhshme dhe, në rast rikonfirmimi të postit, mandati i tyre përfundon në të njëjtën kohë me atë të personave të ngarkuar në këtë detyrë që nga koha e emërimit të tyre.

Nëse për shkaqe të ndryshme pakësohet gjysma e administratorëve, ata që mbeten, duke përfshirë edhe presidentin, quhen të larguar nga detyra dhe duhen marrë masa në mbledhjen e Asamblesë për emërimin e Këshillit administrativ.

Neni 12

Këshilli administrativ mblidhet pranë selisë qendrore në Shqipëri ose në Itali, rregullisht të paktën çdo dy muaj, dhe në ndonjë rast të jashtëzakonshëm, kur presidenti e quan me rëndësi dhe kur e kërkon të paktën një e treta e administratorëve ose Kolegji i kontrollorëve.

Njoftimi i mbledhjes, në të cilën tregohet ora, dita, vendi i mbledhjes dhe objektet që do të trajtohen në rendin e ditës, duhet t'u dërgohen administratorëve dhe kontrollorëve efektivë të paktën tetë ditë para datës së fiksuar të mbledhjes; vetëm në raste urgjente afati i njoftimit mund të ulet deri në 48 orë; njoftimet në një rast të tillë bëhen me telegram, teleks ose telefaks.

Mbledhja e Këshillit është e vlefshme me pjesëmarrjen e shumicës së anëtarëve të tij.

Vendimet merren me shumicën absolute të votave. Nëse ka vota të barabarta, votimi përsëritet. Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit firmosen nga presidenti dhe sekretari.

Neni 13

Këshilli administrativ është i veshur me pushtet të plotë për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Bankës, duke qenë kompetenca e saj çdo veprim që, sipas statutit, nuk është rezervuar shprehimisht në Asamblenë e ortakëve.

Janë rezervuar në kompetencën e Këshillit administrativ vendimet për:

- a) Emërimin e administratorit të deleguar.
- b) Formën e bilancit që i paraqitet Asamblesë dhe propozimet për shpërndarjen e fitimeve.
- c) krijimin, shpërndarjen dhe transferimin e filialeve dhe zyrave të përfqësimit.
- d) Blerjen, shitjen dhe shkëmbimin e pasurisë së patundshme.

dh) Verifikimin e vlerave të të mirave materiale dhe të kredive të dhëna në kapital.

Këshilli përcakton edhe kompetencat përsa i përket dhënies së kredisë, që i atribuohen administratorit të deleguar.

Veprimet e kreditit, të mirautara nga administratori i deleguar, duhet t'i bëhen të njohura Këshillit administrativ sipas mënyave dhe kufijve të përcaktuar nga vetë Këshilli.

Këshilli, për plotësimin e akteve të caktuara ose të kategorive të caktuara, do të mund të japë me prokurë të drejtën për të firmosur për Bankën një a më shumë anëtarëve ose funksionarëve të vetë Bankës si dhe personave të huaj.

Neni 14

Administratorët kanë të drejtë të mbulojnë shpenzimet e kryera për ushtrimin e funksioneve të tyre, si dhe shpërblimin vjetor të caktuar nga Asambleja për çdo vit; vendimi i mëparshëm është i vlefshëm deri në një vendim tjetër të vetë Asamblesë.

Këshilli administrativ përcakton edhe shpërblimin më të lartë për presidentin edhe administratorin e deleguar.

PRESIDENT

Neni 15

Presidenti i Bankës është përfaqësuesi ligjor i Bankës, mbledh dhe kryeson Asamblenë e ortakëve dhe mbledhjet e Këshillit administrativ, mbikëqyr zbatimin e vendimeve të organeve të lartpërmendura dhe ecurinë e shërbimeve të shoqërisë.

E drejta e firmës së veçantë i përket presidentit, sipas kufijve dhe mënyave të përcaktuara nga Këshilli administrativ.

Në rastet e mungesës së presidentit ose daljes së ndonjë pengese tjetër për të, funksionet i kryen zëvendëspresidenti e në mungesë të tij, këshilltari më i vjetër. Konsiderohet si këshilltari më i vjetër ai që ka më shumë kohë në Këshillin Administrativ, dhe në rast se kjo kohë është e njëjtë, do të konsiderohet ai që ka moshë më të madhe. Pra, firma e personit që zëvendëson presidentin, provon mungesën e presidentit dhe në rastin tjetër të zëvendëspresidentit.

ADMINISTRATORI I DELEGUAR

Neni 16

Administratori i deleguar mund të japë autorizime në kuadrin e pushtetit që i është dhënë. I përket administratorit të deleguar t'i propozojë Këshillit administrativ çdo lloj vendimi përsa i përket shpërndarjes së kredive dhe në përgjithësi të operacioneve bankare e financiare.

PERSONELI

Neni 17

Është e ndaluar për të gjithë personelin e Bankës të hyjë në marrëdhënie detyrimi me Bankën, qofshin këto direkte apo indirekte. Duke u nisur nga motive të veçanta, Këshilli administrativ mund të parashtojë marrëdhënie detyrimi të veçanta dhe të përcaktuara mirë ndërmjet punonjësve dhe Bankës.

KOLEGJI KONTROLLUES

Neni 18

Kolegji kontrollues përbëhet nga tre kontrollues efektivë dhe dy zëvendësues. Në rast pezullimi të një kontrolluesi të emëruar nga Asambleja, vendin e zë kontrollori zëvendësues me moshë më të vjetër. Kontrolluesi i ri do të qëndrojë deri në Asamblenë e ardhshme e cila duhet të marrë masa

për emërimin e kontrolluesve efektivë dhe të zëvendësuesve të nevojshëm për plotësimin e kolegjit. Asambleja përcakton shpërblimin vjetor fiks që i takon kontrollorëve për gjithë kohën e detyrës. Kontrollorëve u përket edhe mbulimi i shpenzimeve të kreyra për ushtrimin e funksioneve të tyre.

Kontrolluesit efektivë kanë të drejtën e ndërhyrjes në mbledhjet e Asamblesë dhe të Këshillit Administrativ.

Kolegji i kontrolluesve duhet të mbledhet të paktën çdo tremujor. Për mbledhjet duhet të përpilohet procesverbali dhe të hidhen më pas në librin përkatës të mbledhjeve në Kolegjin e kontrollorëve, të nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Neni 19

Kolegji i kontrollorëve duhet:

a) Të kontrollojë respektimin e ligjit, të rregullave, statutit dhe dispozitave të mbikëqyrjes bankare.

b) Të verifikojë mbajtjen e rregullt të kontabilitetit të shoqërisë, si dhe të kontrollojë lidhjen e bilancit me llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, që rezultojnë në librat e dokumentet kontabël.

c) Të paktën çdo tremujor para mbylljes së bilancit të sigurojë, mbi inventarin e librave të shoqërisë, gjendjen e arkës, ekzistencën e vlerave dhe titujve të pasurisë, ose të mbajtura peng në ruajtje ose në kujdesin e tyre.

BILANCI

Neni 20

Bilanci i shoqërisë mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti. Bilanci ushtrimor, me llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, përpilohet nga Këshilli administrativ dhe i komunikohet Kolegjit të kontrollorëve me relacionin dhe dokumentet justifikuese, të paktën 15 ditë para diskutimit të tij nga Asambleja.

Të ardhurat neto të nxjerra nga bilanci, të miratuara nga Asambleja do të përdoren si vijon:

- Jo më pak se 20 për qind për fondin e rezervës së detyrueshme.

- Teprica për aksionarët ose për fondet e tjera rezervë.

Megjithatë Asambleja do të mund të vendosë edhe për mosndarjen e asnjë të ardhure ose të kalimit të gjithë të ardhurve në një fond rezervë a në shtimin e kapitalit themelor.

Pagesat e dividendit do të kryhen pranë arkave të përcaktuara nga Këshilli administrativ brenda afatit për çdo vit të caktuar nga vetë ai.

SHPËRNDARJA

Neni 21

Duke arritur në çdo kohë ose për çfarëdolloj shkak në shpërndarjen e Bankës, Asambleja pëcakton mënyrat e likuidimit dhe emëron një a më shumë likuidues, duke caktuar kompetencat e kompensimet.

TË NDRYSHME

Neni 22

Pjesëmarrësit në Asamble dhe në Këshillin administrativ mund të përdorin materiale të redaktuara në gjuhën shqipe, italiane ose angleze.

Tiranë, më 16.12.1992

